

V E N D I M
Nr.543, datë 21.8.1998

PËR TARIFAT E UJITJES

Në mbështetje të nenit 10 të ligjit nr.8111, datë 28.3.1996 "Për një ndryshim në ligjin nr.7846, datë 21.7.1994 "Për ndërtimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e sistemeve ujitëse dhe kulluese", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i ministrave

V E N D O S I:

1. Tarifat e ujitjes për veprat dhe sistemet ujitëse që administrohen nga drejtoritë e ujërave, të jenë sipas kostos reale, mbi bazën shpenzimeve për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre, duke i bashkërenduar me shoqatën e përdoruesve të ujit.

Shoqatat e përdoruesve të ujit, të cilat e blejnë ujin nga këto sisteme, mbledhin tarifën e ujit si më sipër, së bashku me shtesën e caktuar nga vetë shoqata, mbështetur në buxhetin e hartuar prej saj.

2. Tarifat e ujit për ndërmarrjet shtetërore në varësi të Institutit të Kërkimeve të Peshkut, Durrës dhe për subjektet private, që prodhojnë rasa peshku, të jetë 0.3 lekë për m³ ujë.

3. Tarifat e ujit, për arsye të tjera, që nuk përmenden në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, të jetë sipas kostos reale, por jo më shumë se 15 lekë/m³ ujë teknologjik të dhënë.

4. Subvencioni për drejtoritë e ujërave të përdoret kryesisht për mirëmbajtjen e sistemeve kryesore kulluese, të argjinaturave mbrojtëse nga vërshimi i lumenjve dhe për hidrovoret.

5. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

